




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENSIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
DREJTORIA RAJONALE E OFRIMIT FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK
ELBASAN



Nr 241 Prot

Elbasan më, 01.07.2021

Lënda: Njoftim për lëvizje paralele

DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSË
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARË TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE.

Në zbatim të ligjit nr 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr 554 datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; të udhëzimit nr 14 datë 27.05.2021 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publik të arsimit dhe formimit profesional".

Ofruesi publik i AFP-së Drejtorisë Rajonale të Ofritit Formimit Profesional Publik Elbasan, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin:

- Përgjegjës i sektorit të administrimit - 1 person

I. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme:

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) Të jetë kushte shëndetësorë që e lejojnë të kryejë detyrën

- c) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) Të demostrojë vlera të larta të etikës, sjelljes, dhe komunikimit;
- f) Të demostrojë aftësi të organizimit dhe planifikimit strategjik, aftësi analitike për zgjidhjen e problemeve.
- g) Të demostrojë aftësi drejtuese të punës në grup dhe motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) Të ketë diplomë të studimeve universitare të nivelit "Master shkencor" (ose të barazvlefshme) në një nga fushat që lidhet me kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së.
- b) Të ketë të paktën kategorinë " Mësues i kualifikuar"
- c) Të ketë punuar të paktën 5 vjet në një ofrues publik të AFP-së
- d) Të ketë njohuri të certifikuara në përdorimin e teknologjisë së informacionit.
- e) Të ketë përvojë pune të paktën 3 vjet në fushën që lidhet me kualifikimet profesionale të njërit prej drejtimeve mësimore të ofruesit të AFP-së.

Dokumentet e aplikimit

1. Dosja e aplikantit e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë , duhet të përfshijë.
 - letërmotivimin për pozicionin;
 - jetëshkrimin (CV-në)
 - kartën e indentitetit
 - diplomë
 - librezë e punës
 - çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trainimet apo të tjera të përmendura në jetëshkrim;
 - certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
 - vërtetim i gjëndjes shëndetësore
 - vërtetimin e gjëndjes gjyqësore
 - vërtetim nga punëdhënësi i fundit , që ndaj tij nuk ka masa disiplinore në fuqi;
 - rekomandim ose vlerësim pune nga punë dhënës të mëparshëm;
 - dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;
 -
2. Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.
3. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së brenda datës.....16.07.2021 .

